

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI PER KRIME TE RENDA**-si gjykatë e shkallës së parë, me gjyqtarin Musa Konxheli kryetar i trupit gjykues, Hysnije Gashi anëtare dhe Bekim Salihu anëtar, sekretare juridike Lavdije Brahimi në lenden penale kundër të akuzuarve B.B., H.I., F.I., F.A.1, S.B. dhe Xh.A. për shkak të veprës penale grabitje nga neni 255 par.3 lidhur me par.1 të KPK-së si dhe veprën penale mbajtja ne pronesi kontroll, posedim dhe shfrytëzim te paautorizuar nga neni 328 par.2 te KPK-së dhe veprën penale mbajtja ne pronësi kontroll posedim dhe shfrytëzim te paautorizuar te armeve nga neni 374 par.1 të KPK-së , sipas aktakuzës së ish Prokurorisë Publike të Qarkut në Prishtine PP.nr.456-6/2008 të datës 25.08.2008, dhe aktakuzës se Prokurorisë Themelore ne Ferizaj-Departamenti per Krime te Renda PP.nr.456-6/08 te dt.13.01.2015, pas mbajtjes se shqyrtimit gjyqësor me dt. 27.04.2016 në prani te Prokurorit te shtetit Florije Salihu- Shamolli, të akuzuarve me dt. 27.04.2016 shpallë dhe publikisht komunikon këtë:

**A K T G J Y K I M**

1. I pandehuri, **B.B.** nga i ati Rr., e ëma H. e vajzërisë R., data e lindjes.....në Shkup Republika e Maqedonisë, me vendqëndrim ne fsh..... Komuna Kaçanik, i martuar baba i dy fëmijëve, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes se varfër ekonomike, i pa punë. Në paraburgim ka qëndruar nga dt.09.06.2008 deri me dt. 11.05.2011.

2. I pandehuri **H.I.** nga i ati N. e ëma Z. e vajzërisë Sh., data e lindjes.....në Fshatin ..... Komuna e Vitisë ku edhe banon, i martuar, baba i tre fëmijëve, shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës. Në paraburgim ka qëndruar nga dt.09.06.2008 deri me dt.11.05.2011.

3. I pandehuri **F.I.** nga i ati R. e ëma S. e vajzërisë Sh., data e lindjes..... në fshatin ..... Komuna e Vitisë ku edhe banon, i martuar, baba i dy fëmijëve, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës. Ka qëndruar në paraburgim nga dt.09.06.2008 deri me dt.11.05.2011.

4. I pandehuri **F.A.1** nga i ati J. e ëma B. e vajzërisë A., data e lindjes.....në fsh. .... Komuna e Vitisë ku edhe banon, i martuar, baba i pesë fëmijëve, i gjendjes se varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës. Ka qëndruar në paraburgim nga dt.09.06.2008 deri me dt.11.05.2011

5. I pandehuri **S.B.** nga i ati D. e ëma T. e vajzërisë A., data e lindjes..... në fsh. .... Komuna e Vitisë ku edhe banon, i martuar, baba i katër fëmijëve, ka mbaruar shkollën fillore, i gjendjes se varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës. Ka qëndruar në paraburgim nga dt.09.06.2008 deri me dt.11.05.2011

6. I pandehuri **F.A.2** nga i ati M. e ëma N. e vajzërisë H., data e lindjes..... në Gjilan ndërsa me vendbanim ne fsh. .... Komuna e Vitisë, i martuar, baba i tre fëmijëve, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës. Ka qëndruar në paraburgim nga dt.09.06.2008 deri me dt.09.12.2010.

7, I pandehuri **Xh.A.** nga i ati D. e ëma B. e vajzërisë S., ..... në fsh. .... Komuna e Vitisë ku edhe banon, i martuar, baba i dy fëmijëve, i gjendjes se varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës. Ka qëndruar në paraburgim nga dt.31.10.2014 deri me dt.24.10.2015.

**JANË FAJTOR**

**Sepe** Me dt. 09.06.2008 rreth orës 08:06 në Ferizaj ne rrugën’’ Vëllezërit Gërvalla’’ në filialin e ..... të akuzuarit B.B., H.I., F.I., F.A.1 dhe S.B. me qëllim të përfitimit direkt si pjesë e grupit të organizuar kriminal në atë mënyrë që të pandehurit B.B. dhe H.I. kanë bërë një plan paraprak për të grabitur filialin ..... në Ferizaj dhe pasi kanë bërë planin ata kanë kontaktuar me të pandehurin F.I. të cilit i kanë kërkuar të gjejë një person të besueshëm i cili do të futet në bankë së bashku me të pandehurin B.B., kështu që i pandehuri F.I. ka kontaktuar me të pandehurin Xh.A. i cili për një kohë ka qenë në arrati. Pasi që ky ka pranuar propozimin të katërt janë takuar njëri me tjetrin në kafiterinë ‘’.....’’ në Ferizaj ku ata kanë ndarë rolet për secilin prej tyre dhe janë informuar për kohën e kryerjes së veprës penale kështu që me dt. 09.06.2008 rreth orës 08:06 minuta me makinën e markës Golf II, ngjyrë e gjelbërt, me targa ..... pronë e të pandehurit S.B. i cili pas marrëveshjes H.I. dhe S.B. kanë lënë makinën në oborrin e shtëpisë së tij të hapur me qelës brenda, të pandehurit B.B. dhe Xh.A. kanë shkuar përballë bankës e cila gjendet në rrugën ‘’Vëllezërit Gërvalla’’ në Ferizaj kanë ndaluar makinën kanë dalë nga makina me maska të maskuar, me dorëza pune dhe të armatosura me revole që i mbanin në dorë, shpejt kanë hyrë brenda ku i pandehuri Xh.A. ka drejtuar revolen drejt rojës së sigurisë në hyrje të ndërtesës duke i detyruar ata të shtrihen në dysheme duke i kërcënuar se nëse lëvizin do të ju vrasim, ndërsa i pandehuri B.B. me revole ka shkuar tek zyrja e parave duke i kërcënuar ata me revole ka marrë nga dollapët gjithë paratë, i ka futur atë në qante boshe të Bankes, ka marrë një qante tjetër dhe i ka mbushur me para, pastaj të dytë kanë dalë nga banka, janë larguar shumë shpejt në të njëjtën makinë me këtë rast kanë marrë sasinë e parave 111.182.92 € dhe 196.889 USD dhe 40 franga Zvicere ku ata kanë mbërritur në qendrën e mjekësisë rajonale në Ferizaj ashtu siq kishin bërë marrëveshje përpara. I pandehuri F.A.2 ka qenë duke pritur në makinën e tij ngjyrë qershie ‘’Opel Vectra’’ me targa ..... sipas marrëveshjes së mëparshme me të pandehurin F.A.1, i pandehuri H.I. i kishte premtuar atë para në vlerë prej 10.000 € nga të cilat 1000€ do të i jepeshin pronarit të makinës, ata kanë vendosur çantat me para në makinë ku i pandehuri Xh.A. ka hyrë dhe ka reduktuar me një shpejtësi drejt Gjilanit ndërsa i pandehuri B.B. ka marrë një taksë dhe ka shkuar në restorantin ‘’.....’’ në rrugën kryesore Ferizaj-Kaçanik ku

ka pirë një kafe, ka bërë disa telefonata nga telefonat e kamerierëve dhe ne fund revolen e përdorur me lart e ka hudhur ne koshin e plehrave në korridorin e banjos, ndërsa në anën tjetër të pandehurit Xh.A. dhe F.A.2 kanë vazhduar me makinë në drejtim të kundërt afër fsh. ...., aty kanë marrë qantat me para dhe janë larguar afër fshatit ....., ku ata kanë vendosur parat në çantat sportive me ngjyrë vishnje, i pandehuri Xh.A. ka marrë një sasi parash pas premtimit të mëparshëm i ka dhënë të pandehurit F.A.2 3.000€ dhe 5.100 USD dhe janë ndarë aty, pas ndarjes i pandehuri Xh.A. është takuar me të pandehurin B.B., H.I. dhe F.A.1 janë takuar ne kafiterin ‘’.....’’ ku janë arrestuar nga policia, më vonë janë arrestuar edhe të pandehurit tjerë ndërkaq i pandehuri Xh.A. ka ikur dhe ka marrë me vete 40.000€.

**-Me qka në bash kryerje kanë kryer veprën penale grabitje nga neni 255 par.3 lidhur me par.1 lidhur me nenin 23 të KPRK-së.**

**Xh.A.**

Nga data e pacaktuar gjerë më datë 09.06.2008 ka mbajtur pa autorizim një revole të markës së panjohur, e cila revole është përdorur në mënyrë frikësuese dhe kërcënuese ndaj punëtorëve të sigurimit të ..... gjatë kryerjes së veprës penale grabitje në filialet e .....

Në bazë të dispozitës së sipërcituar si dhe dispozitat nga nen 3, 41, 42, 43, 44. par. 4, 64 të KPPK-së si dhe nenit 391 të KPPPK-së

Për veprën penale nën. (1) dënim burgimi në kohëzgjatje prej 3/ tre/ muaj

Për veprën penale nën. (2) dënim burgimi në kohëzgjatje 3/tre/ muaj.

**G J Y K O N**

1. I pandehuri **B.B.**, Ne pajtim me nenin 38 te KPK-se dhe nenin 255 par.2 lidhur me par.1 te KPK-se ne bashkëkryerje sipas nenit 23 te KPK-se, dënohet me 3/tre/ vjet burg.
2. I pandehuri **H.I.** ne pajtim me nenin 38 te KPK-se dhe nenin 255 par.2 lidhur me par.1 te KPK-se ne bashkëkryerje sipas nenit 23 te KPK-se, dënohet me 3/tre/ vjet burg.
3. I pandehuri **F.I.** ne pajtim me nenin 38 te KPK-se dhe nenin 255 par.2 lidhur me par.1 te KPK-se ne bashkëkryerje sipas nenit 23 te KPK-se, dënohet me 2/dy/ vjet burg.
4. I pandehuri **F.A.1**, ne pajtim me nenin 38 te KPK-se dhe nenin 255 par.2 lidhur me par.1 te KPK-se ne bashkëkryerje sipas nenit 23 te KPK-se, dënohet me 3/tre/ vjet burg.
5. I pandehuri **S.B.**, ne pajtim me nenin 38 te KPK-se dhe nenin 255 par.2 lidhur me par.1 te KPK-se ne bashkëkryerje sipas nenit 23 te KPK-se, dënohet me 2/dy/ vjet burg.
6. I pandehuri **Xh.A.**, ne pajtim me nenin 38 te KPK-se dhe nenin 255 par.2 lidhur me par.1 te KPK-se ne bashkëkryerje sipas nenit 23 te KPK-se, dënohet me 2/dy/ vjet e 6/gjasht/ muaj burg, ndërsa per veprën penale mbajtja ne pronësi kontroll posedim dhe shfrytëzim te paautorizuar te armeve nga neni 374 par.1 të KPK-së, dënohet me dënim burgimi prej 1/nje/ viti  
**Denimi unik per dy veprat penale do te jete 3/tre/ vjet burg.**

**Koha e qëndrimit ne paraburgim dhe arrest shtëpiak te pandehureve te shp[allur fajtor, do tju llogaritet ne dënimin kryesor ndërsa pjesa e mbetur do te ekzekutohet pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.**

**Te akuzuarit, ne menyre te përbashkët do te kompenzojne palën e dëmtuar/ ...../ per demet e shkaktuara te përcaktuara pas kërkesës ne shume 44.742,11/katerdhjete e katërmijë e shtatqinde e katerdhjete e dy euro e njembedhjet cent/€ dhe 4.900\$/katërmijë e nentqinde /dollarë.**

**Ne pajtim me nenin 60 te KPK-se, konfiskohen ne menyre te perhereshme, revolja e markës Ceska Zbrojevka, model VZOR 50 e kalibrit 7.65x 17 mm, nr.serik D-30238,prodhim Qek, 15 plumba te kalibrit 15 mm, makina Volksëagen model Golf,numri i regjistrimit ..... dhe makina Opel Vectra,numri i regjistrimit ..... Si dhe një revole të markës së panjohur te cilën e ka përdor i pandehuri Xh.A. per ti frikësuar punetoret e .....-.**

**Në emër të shpenzimeve të procedures penale te pandehurit secili veq e veq obligohet ta paguaj shumën prej nga 50€ , si paushall gjyqësor, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.**

### **A r s y e t i m i**

Prokuroria Publike e Qarkut në Prishtine ka ngrit aktakuzen PP.nr.456-6/2008 të datës 25.08.2008 kundër të akuzuarve B.B., H.I., F.I., F.A.1, S.B. dhe F.A.2, për shkak të veprës penale grabitje nga neni 255 par.3 lidhur me par.1 të KPK-së si dhe vepren penale mbajtja ne pronesi kontroll, posedim dhe shfrytëzim te paautorizuar nga neni 328 par.2 te KPK-së dhe vepren penale mbajtja ne pronësi kontroll posedim dhe shfrytëzim te paautorizuar te armeve nga neni 374 par.1 të KPK-së ndërsa Prokuroria Themelore ne Ferizaj-departamenti per krime te renda ka ngritur aktakuze PP.I.nr.456-6/08 te dt.

13.01.2015 kunder te pandehurit Xh.A. nga fsh.....,komuna Viti per shkak te veprës penale: grabitje nga neni 255 par.3 lidhur me par.1 te KPK-se dhe veprën penale: mbajtja ne pronësi, posedim dhe kontroll ne menyre te paautorizuar te armeve nga neni 328 par.1 te KPK-se

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale mbajti shqytimin gjyqësor publik me date 15.04.2016, në të cilën përfaqësuesi i akuzës prokurorja e shtetit, Florije Shamolli, propozoi qe procedura penale ndaj te pandehurit F.A.2 te veqohet me qe i njëjti sipas verifikimit te kryer nga organet kompetente gjendet jashtë Kosoves. Propozimin e prokurores se qeshtjes nuk e kundërshtoi as mbrojtja e te akuzuarëve tjerë ne aktakuze, andaj trupi gjykues bazuar ne nenin 34 par.2 te KPPK-se VEQOI procedurën penale ndaj te akuzuarit F.A.2, per veprën penale: grabitje ne bashkryerje nga neni 255 par.2 lidhur me par.1 lidhur me nenin 23 te KPK-se.

Gjithashtu ne kete seancë gjyqesore prokurria e rastit i propozoi trupit gjykues qe aktakuza e ngritur per te akuzuarin Xh.A. e dt.13.01.2015 te udhhiqet e bashkuar me aktakuzën e dt.25.08.2008 ku janë te akuzuar B.B., H.I., F.I., F.A.1 dhe S.B..

Propozimin e prokurores se rastit sa i përket bashkimit te këtyre dy aktakuzave nuk e kundërshtoi mbrojtja e te pandehurëve.

Trupi gjykues duke u bazuar ne nenin 33 par.7 te KPPK-se,solli AKTVENDIM per BASHKIM te aktakuzës se ish Prokurorise Publike te Qarkut në Prishtine me nr. PP.nr.456-6/2008 të datës 25.08.2008 e ngritur kundër të akuzuarve B.B., H.I., F.I., F.A.1, S.B. dhe F.A.2, për shkak të veprës penale grabitje nga neni 255 par.3 lidhur me par.1 të KPK-së si dhe per te pandehurin B.B. edhe per vepren penale mbajtja ne pronesi kontroll, posedim dhe shfrytëzim te paautorizuar nga neni 328 par.2 te KPK-së me aktakuzën e Prokurorise Themelore ne Ferizaj-Departamenti per Krime te Renda me nr. PP.I.nr.456-6/08 te dt. 13.01.2015 kunder te pandehurit Xh.A. nga fsh....., komuna Viti per shkak te veprës penale: grabitje nga neni 255 par.3 lidhur me par.1 te KPK-se dhe veprën penale: mbajtja ne pronësi, posedim dhe kontroll ne menyre te paautorizuar te

armeve nga neni 328 par.1 te KPK-se, dhe se tani e tutje do te udhhiqet vetëm nje procedure penale ndaj te pandehureve te lartecekur per veprat penale te lartecekura..

Ne seancën e shqyrtimit gjyqësor te dt.27.04.2016 pas leximit te aktakuzave PP.nr.456-6/2008 të datës 25.08.2008 nga prokurorja e shtetit znj. Florije Salihu-Shamolli, te pandehurit:

- **B.B.** deklaroi: e pranoj fajësinë për veprën penale me te cilën me ngarkon akuza, pendohem dhe premtoj se ne te ardhmen nuk do te përsëris veprën e kësaj natyre.
- **H.I.** deklaroi: pranoj fajësinë për veprën penale me te cilën me ngarkon akuza . Pendohem dhe premtoj se ne te ardhmen nuk do te përsëris vepra te kësaj natyre.
- **F.I.** deklaroi: pranoj fajësinë për veprën me te cilën me ngarkon akuza . Pendohem dhe premtoj se ne te ardhmen nuk do te përsëris vepra te kësaj natyre.
- **F.A.1** pranoj fajësinë për veprën penale me te cilën me ngarkon aktakuza. Pendohem dhe premtoj se ne te ardhmen nuk do te përsëris vepra te kësaj natyre
- **S.B.** deklaroi: pranoj fajësinë për veprën penale me te cilën me ngarkon aktakuza. Pendohem dhe premtoj se ne te ardhmen nuk do te përsëris vepra penale te kësaj natyre.
- **Xh.A.** deklaroi: pranoj fajësinë për veprën penale me te cilën, me ngarkon aktakuza. Pendohem dhe premtoj se ne te ardhmen nuk do te përsëris vepra te kësaj natyre, në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se e pranonë fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon akuza duke theksuar se është penduar për veprën e kryer dhe se pas kësaj ngjarje i ka kërkuar falje të dëmtuarit, është zotuar se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla duke i propozuar gjykatës që ti shqiptojë një dënim sa ma të butë.

Gjykata konstatoi se janë plotësuar kriteret nga nen. **315 par.1. të KPPK-së**, pasi që i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, një pranim i tillë është bërë vullnetarisht dhe mbështetet në faktet dhe provat e çështjes e kësaj çështje penale, andaj shqyrtimi gjyqësor konformë nen. **359 par.5. të KPPK-së** ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve.

Prokurorja e shtetit Florije Salihu-Shamolli ne fjalën përfundimtare deklaron: Nga vet pranimi i fajësisë së të akuzuarve i cili pranim është bërë në mënyrë vullnetare dhe i njëjti përputhet me të gjitha shkresat e lëndës vërtetohet se të akuzuarit kanë kryer veprën penale në bashkëkryerje grabitje nga neni 255 par. 3 lidhur me 1 dhe nenin 23 të KPK-së.

Andaj i propozoj Trupi Gjykes që të njëjtit t'i shpall fajtor dhe ti dënoj me dënim sipas ligjit, gjithashtu propozoj Trupi Gjykes që me rastin e matjes së dënimit për të akuzuarit si rrethanë lehtësuese ta marrë se të njëjtit kanë qenë të sinqertë para gjykatës kanë pranuar fajësinë që nga ajo kohë më nuk kanë përsëritur vepra penale. Ndërsa si rrethanë rënduese gjykata të merre parasysh edhe rrezikshmërinë e kësaj vepre penale, mënyrën se si është kryer dhe mbi bazën e të gjitha këtyre të njëjtëve t'iu shqiptoj një dënim me të cilën të njëjtit nuk do të kryejnë vepër penale. Gjithashtu propozoj që të konfiskohet arma në mënyrë të përhershme.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar”.....” - av. K.K. nga firma e avokatisë “.....”, në fjalën e tij përfundimtare deklaron: qëndroj pranë kërkesës pasurore juridike në shumë prej 44.732.11€ dhe 4900\$, të cilat janë nxjerrë sipas bilancit të bërë nga banka e që përputhen me shkresat e lëndës e në veçanti me zbritjen që bëhet nga shuma sipas dispozitivit të aktakuzës dhe mjeteve materiale të konfiskuara nga policia e të cilat i janë kthyer bakës.

Mbrojtësi i të akuzuarit B.B. - av. A.I., dorëzon fjalën përfundimtare me shkrim Trupi Gjykes dhe të njëjtën e elaboron në këtë shqyrtim gjyqësor.

Gjithashtu shton se lidhur me kërkesën pasurore juridike i propozoj gjykatës që të udhëzohet në kontest civil.

I akuzuari B.B. në fjalën e tij përfundimtare deklaron: e përkrah në tërësi fjalën e mbrojtësit tim vjetër nuk kam se çka të shtoj.

Mbrojtësi i të akuzuarit H.I. - av. Z.Z. në fjalën e tij përfundimtare deklaron: duke qenë se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për një veprë e cila ka një sanksion bukur të rëndë dhe fakti se një pranim të tillë e ka bërë shumë me vetëdije pastaj i akuzuari H.I. gjatë gjithë procedurës penale të zhvilluar pranë kësaj gjykate dhe gjykatave të tjera ka qenë shumë kooperativ me oraganet e ndjekejs. Si dhe fakti se nga një distancë kohore nga kryerja e kësaj vepre rreth 8 vite nuk ka kryer asnjë veprë tjetër penale mendoj se gjykata duhet ti ketë parasysh edhe faktin se i akuzuari edhe para kryerjes së kësaj vepre nuk ka qenë në evidenca të kryesve të veprave penale mendoj se është një rrethanë lehtësuese dhe shumë bindëse se i akuzuari është hera e parë që ka rënë në desh me ligjin si dhe është penduar se ka kryer një veprë të tillë pendimin e konfirmon edhe koha pas daljes nga paraburgimi që dëshmon se i njëjti nuk ka bërë asnjë shkelje ligjore – nuk ka kryer asnjë vepre tjetër penale, pastaj sa i përket statusit të tij familjar është baba i tre fëmijëve me një gjendje të varfër ekonomike dhe premtimin se nuk do ta përsërisë për asnjë çast një veprë të tillë apo ndonjë veprë tjetër penale, mendoj se janë rrethana lehtësuese për gjykatën gjatë shqiptimit eventual të sanksionit penal, gjithashtu gjykatës i propozoj që me që e dëmtuara thuhet se ka rikthyer 80% e më shumë të mjeteve monetare dhe shuma e precizuar nga përfaqësuesi i të dëmtuarës e lartshënuar që në vendimin e gjykatës e dëmtuara të udhëzohet për realizimin e kërkesës pasurore – juridike në kontest civil pavarësisht precizimit që i ka bërë sot me që janë në pyetje 5 të akuzuar dhe se vështirë do të përcaktohej se çdo njëri nga të akuzuarit ka përfituar shumë të njëjtë nga shuma e precizuar nga e dëmtuara. Dhe për këtë çështje kontesti civil është procedura më reale në këtë çështje, nga të theksuarat i propozoj gjykatës që të akuzuarit t'i shqiptoj një sanksion sa më të ulët me të cilin do të arrihej efekti i sanksionit në të akuzuarin.

I akuzuari H.I. në fjalën e tij përfundimtare deklaron: e përkrah në tërësi fjalën e dhenë nga mbrojtësja im tjetër nuk kam se çka të deklaroj.

Mbrojtësi i të akuzuarit F.I. - av. A.R., në fjalën e tij përfundimtare deklaron: e mbështes në tërësi fjalën përfundimtare të kolegut tim av. A.I. sa i përket cilëzimit juridik rrethanave lehtësuese dhe periudhës së kaluar kohore, i mbrojturi im F.I. ka qëndruar në paraburgim plot dy vite dhe atë prej dt. 09.06.2008 deri më dt. 09.06.2010. nga gjykata e

shkallës së parë në Prishtinë është dënuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 2 vitesh. Gjatë kohës së qëndrimit në paraburgim ai në tërësi është risocializuar dhe familjes dhe shoqërisë i është kthyer si anëtar i vyeshëm. Prej datës kur është liruar nga paraburgimi e deri më sot kanë kaluar gati 6 vite dhe ai asnjëherë nuk ka qenë në kundërshtim me ligjin. Prej fillimit ka qenë kooperativ, është i gjendjes së keqe shëndetësore, i gjendjes së varfër ekonomike dhe ju lus që me rastin e vendosjes për lartësinë dhe llojin e vendimit të keni parasysh të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në dënimin e shqiptuar, ai ka premtuar se më nuk do të kryej vepra penale, se është risocializuar në tërësi e kjo rezulton edhe nga sjelljet e tij pas lirimit nga paraburgimi. Lidhur me kërkesën pasurore – juridike të përfaqësuesit të palës së dëmtuar unë propozoj që i njëjti për realizimin e kësaj kërkesë të udhëzohet në kontest civil për arsye se i mbrojturi im në rastin konkret nuk ka marrë para edhe pse veprën penale e kemi pranuar në tërësi.

I akuzuari F.I. deklaron: e mbështes në tërësi fjalën e mbrojtësit tim dhe nuk kam asgjë për të shtuar.

Mbrojtësi i të akuzuarit F.A.1 - av. B.S. në fjalën e tij përfundimtare deklaron: pasi që i mbrojturi im pranoi fajësinë në tërësi dhe se gjykata pranimin e fajësisë duhet ta merr si rrethanë veçanërisht lehtësuese në këtë rast i akuzuari është penduar thellë për këtë veprë penale dhe në mënyrë publike i kërkon falje palës së dëmtuar dhe gjykatës. Mbrojtja i propozon gjykatës që gjatë vendosjes së kësaj çështje penale- juridike ti merr për bazë rrethanat lehtësuese si në vijim se i akuzuari ka vuajtur masën e paraburgimit në afat prej 3 vitesh si dhe paraqitja në stacion policor po ashtu 3 vite.për këtë veprë penale e cila edhe sot u shqyrtua në këtë seancë. Është familjar është baba i 5 fëmijëve të gjithë të mitur dhe se i akuzuari është i vetmi B.B. i të ardhurave materiale të familjes dhe se ekzistenca e familjes varet kryekëput nga i akuzuari se asnjëherë nuk ka rënë në desh me ligjin ka kaluar një kohë e gjatë nga kryerja e veprës penale dhe se gjatë kësaj periudhe i njëjti asnjëherë nuk ka përsëritur ndonjë veprë penale ose ndonjë inkriminim tjetër. Vetë qëndrimi në masën e paraburgimit prej 3 vitesh e ka arritur efektin e dënimit dhe se i njëjti është risocializuar në tërësi.

Sa i përket kërkesës pasurore – juridike të paraqitur në këtë seancë nga ana e përfaqësuesit të palës së dëmtuar, kjo kërkesë nuk i plotëson kushtet ligjore që të trajtohet në këtë proces penal me arsyetimin se e njëjta nuk ka arsyetuar kërkesën pasurore juridike në formën ligjore ashtu siç edhe kërkohet. Vlen të theksohet se i mbrojturi im nga kjo vepër penale e kryer nuk ka pasur asnjë dobi – përfitim material, prandaj kjo kërkesë e –paraqitur nuk është specifikuar dhe detajuar në veçanti për secilin të akuzuar. Prandaj edhe si e tillë mbrojtja mendon se nuk mund të realizohet në këtë procedurë penale e cila po shqyrtohet. Në propozimin që gjykata palën e dëmtuar ta udhëzoj që për realizimin e kësaj kërkesë pasurore – juridike të udhëzohet në kontest civil.

I akuzuari F.A.1 në fjalën e tij përfundimtare deklaron nuk kam asgjë për të shtuar pos që e përkrah mbrojtjen e dhënë nga mbrojtësi im.

Mbrojtësi i të akuzuarit S.B. - av. A.H., në fjalën e tij përfundimtare deklaron: e përkrah në tërësi fjalën e dhënë nga kolegët e mi paraprakë, dhe se klienti im për këtë çështje ka qenë i dënuar 2 vite e 6 muaj dhe këto i ka mbajtur në tërësi dhe prej asaj kohe më nuk ka rënë në desh me ligjit.

I propozoj gjykatës që të merr parasysh edhe rrethanat e tij personale se është mbajtës i familjes dhe atë i 5 fëmijëve të mitur dhe J.B. nga bujqësia në një gjendje shumë të rëndë ekonomike. sa i përket kërkesës pasurore – juridike të cilën përfaqësuesi i të dëmtuarës e parashtror ta realizoj në kontest civil edhe pse sipas deklaramit të klientit tim i njëjti nuk ka përfituar asgjë, por vetëm ka humbur auto veturën e tij “Golf”. Prandaj i propozoj Trupi Gjykes që gjatë matjes së dënimit ti shqiptoj një dënim sa më të butë me që i njëjti veç e ka kryer dënimin.

I akuzuari S.B. në fjalën e tij përfundimtare deklaron nuk kam asgjë për të shtuar pos që e përkrah mbrojtjen e dhënë nga mbrojtësi im.

Mbrojtësi i të akuzuarit Xh.A. av. J.B., në fjalën e tij përfundimtare deklaron: përveç rrethanave të përgjithshme lehtësuese të cilat në mënyrë të detajuar i shpjeguan mbrojtësit e tjerë e në veçanti av. A.I. Dëshiroj të shtoj se klienti im ka edhe rrethana të

tjera personale që gjykata duhet ti marrë parasysh gjatë përcaktimit të lartësisë dhe llojit të dënimit.

I mbrojturi im për shkak të një aksidenti që ka pësuar ka pësuar një invaliditet të rëndë e të cilin e ka bërë plotësisht të pa aftë për punë dhe i njëjti ka nevojë për mjekim të vazhdueshëm nga neurologu dhe neuropsikiatri. Po ashtu një rrethanë tjetër që gjykata duhet të merr parasysh është edhe gjendja tejet e vështirë ekonomike (varfëri e skajshme) me të cilën J.B. klienti im dhe familjarët e tij. Përcaktimi i lartësisë së dënimit apo vlerësimi i rrethanave lehtësuese do të ndihmonte që i mbrojturi im të paktën të qëndronte fizikisht pranë fëmijëve të tij të mitur dhe bashkëshortes së tij. E të cilët në pa mundësi që ti ndihmoj financiarisht së paku tu qëndroj afër. Lidhur me kërkesën pasurore juridike konsideroj se vetë pranimi i fajësisë së të pandehurve ka pasur ndikim negativ për ta individualizuar personin që ka mundur që ti merr dhe ti shpenzoj, se klienti im nuk i ka përfituar këto mjete dëshmohet gjendja e tij financiare si para, gjatë dhe pas kryerjes së veprës penale sepse i njëjti në vazhdimësi ka jetuar në gjendje të rëndë dhe vazhdon ta J.B. një gjendje të tillë. Vendosja e gjykatës përmes këtij aktgjykimi edhe për kërkesën pasurore – juridike të të dëmtuarës do të ishte i pa drejtë i pa bazuar dhe që do ti vie padrejtësisht ndonjërit nga të përfshirë në këtë veprë. Secili nga të akuzuarit duke përfshirë edhe klientin tim pranimin e fajësisë e kanë bërë vullnetarisht por që motivi kryesor ka qenë shpenzimi i beneficioneve që ofron pranimi i fajësisë prandaj gjykatës i propozoj që përveç rrethanave lehtësuese që u përmendën të merret për bazë edhe sinqeriteti i klientit tim.

I akuzuari Xh.A. në fjalën e tij përfundimtare deklaron: e përkrah në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësi tim tjetër nuk kam se çka të deklaroj.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurve B.B., H.I., F.I., F.A.1, S.B. dhe Xh.A., formësohen të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale grabitje ne bashkryerje nga neni 255 par.3 lidhur me par.1 të KPK-së, ndërsa

- Per te pandehurin B.B. edhe per vepren penale mbajtja ne pronesi kontroll, posedim dhe shfrytëzim te paautorizuar nga neni 328 par.2 te KPK-së e cila vepër penale ka hyre ne amnisti si dhe
- Per te pandehurin Xh.A., per vepren penale mbajtja ne pronësi kontroll posedim dhe shfrytëzim te paautorizuar te armeve nga neni 328 par.1 të KPK-së të kryer në mënyrën dhe rrethanat e përshkruara si ne dispozitiv.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nen. 64 të KPPK-së, si rrethana lehtësuese mori se te pandehurit kan pranuar fajësinë, sjelljet e të pandehurve pas kryerjes së veprës penale, pendimin e tyre si dhe zotimin se në të ardhmen nuk do të përsërin vepra të tilla, mbi bazën e këtyre rrethanave vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të pandehureve dhe rrezikshmërinë konkrete të kësaj vepre penale andaj në kompleksitetin e të gjitha këtyre rrethanave i vërtetoi, dënimet e shqiptuara, me bindjen se keto dënime te tilla janë adekuate dhe në proporcion në raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjes, shkallën e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të pandehureve si dhe me të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve në kuptim të preventives speciale dhe asaj gjeneralë.

Koha e qëndrimit ne paraburgim dhe arrest shtëpiak te pandehureve te shpallur fajtor, ju llogaritet ne dënimin kryesor ndërsa pjesa e mbetur do te ekzekutohet pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Te akuzuarit, ne menyre te përbashkët do te kompensojnë palën e dëmtuar/ ...../ per demet e shkaktuara te përcaktuara pas kërkesës ne shume 44.742,11/katerdhjete e katërmijë e shtatëqindë e katerdhjete e dy euro e njëmbëdhjete cent/€ dhe 4.900\$/katërmijë e nentqinde /dollarë.

Ne pajtim me nenin 60 te KPK-se,u konfiskuan ne mënyrë te përhershme, revolja e markës Ceska Zbrojevka, model VZOR 50 e kalibrit 7.65x 17 mm, nr.serik D-30238,prodhim Qek, 15 plumba te kalibrit 15 mm, makina Volksäagen model Golf,numri

i regjistrimit ..... dhe makina Opel Vectra,numri i regjistrimit ..... Si dhe një revole të markës së panjohur te cilën e ka përdor i pandehuri Xh.A. per ti frikësuar punetoret e .....

Konformë nen. 99 dhe 102 të KPPK-së u obliguan te pandehurit secili veq e veq që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën paushallë nga 50€, në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e sipërcekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

**Departamenti per Krime te Renda,F.A.2**

**PKR.nr.7/16, dt. 27.04.2016**

**Sekretarja juridike,**

**Lavdiye Brahim**

**Kryetari i trupit gjykues**

**Musa KONXHELI**

**Këshilla juridike:** kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 /pesëmbëdhjete/ ditëve nga dita e pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, përmes kësaj gjykate.